

KUD 336.71(496.51)

BANKAT DHE SISTEMI BANKAR NË KOSOVË

*Msc. Fidane Spahija,
fidane.spahija@gmail.com*

Abstrakt

Bankat janë një nga institucionet më të rëndësishme të ekonomisë së një vendi. Me rritjen e konkurrencës është rritur dhe rëndësia e tyre. Sipas literaturës kemi banka të nivelit të parë dhe të dytë. Banka e nivelit të parë është banka qendrore kurse nivelit të dytë janë bankat komerciale, investive, afariste, hipotekare, etj. Banka qendrore është subjekt i pavarur juridik dhe kryen të gjitha funksionet në shërbim sa më të mirë të ekonomisë së vendit. Bankat sekondare janë bankat të cilat kryejn shërbime të ndryshme varësisht nga veprimtaria që operojnë.

Shërbimet e bankave dita ditës po shënojnë rritje me qëllim të krijimit të lehtësive për komitentët e vet. Sa u përketë bankave në Kosovë, kemi Bankën Qendrore të Kosovës dhe tetë banka komerciale. BQK-ja është institucion i pavarur i cili mbikqyrë institucionet financiare dhe kujdeset që të kemi një zhvillim më të mirë ekonomik. Bankat komerciale përfshijnë të hyrat më të mëdha të sistemit financiar të Kosovës dhe njëkohësisht ofrojnë lloje të ndryshme të shërbimeve të cilat janë të përafërta me bankat e vendeve evropiane, kjo si pasojë e kapitalit të cilën e posedojnë.

Fjalët kyçe: Banka, llojet, komerciale, qendore, shërbime.

JEL kualifikimi: G0, G2, G21.

Hyrje

Me këtë punim shkencor bëhen përpjekje të sqarohen: Njohuritë mbi definimin dhe rëndësinë e bankave në përgjithësi, llojeve të bankave dhe shërbimeve të tyre në ditët e sotme, dhe krejtësisht në fund flitet rreth bankave që veprojnë në Kosovë. Për hartimin e punimit janë përdorur literatura të ndryshme vendore dhe të huaja, poashtu hulumtime në internet, media elektronike dhe të shkruara. Metodatat e përdorura për të arritur qëllimin e punimit kryesisht janë: analitike, krahasuese, abstraksionit, etj.

1. Ç'është banka?

Banka është një nga institucion më të rëndësishme në ekonominë e një vendi. Ato janë burim kryesor i kredive për individët, familjet, insitucionet e ndryshme, ndërmarrjet, etj. Bankat e para janë paraqitur qysh para 3000 vjetësh në Babiloni, në kuadër të pallateve mbretërore apo tempujve janë kryer punët depozitare dhe dhënia e huasë. Me zhvillimin e tregtisë janë zhvilluar edhe punët bankare. Më parë bankat kanë qenë krijueset e vetme të likuiditetit dhe bartëset e funksionit depozitar. Mirëpo me zhvillimin e ekonomisë bashkëkohore krijohen një mori organizatash të tjera financiare të cilat, krahas me bankat, luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e mobilizimit të mjeteve monetare dhe financimit të nevojave të ekonomisë. Disa nga këto institucione punojnë me emrin bankë, kurse disa të tjera ose shumica e tyre e bazojnë afarizmin në një fushë të ngushtë të aktivitetit financiar. Pra, sot hasim në shumë insitucione financiare të cilat nuk mund të quhen banka dhe pikërisht për këtë arsye është i domosdoshëm definicioni i bankës në mënyrë që të shihet dallimi në mes të organizatave tjera financiare. Koncepti i bankës shpesh barazohet me konceptin e ndërmarrjes kreditore ose institucionit monetar (kreditor). Zakonisht me konceptin bankë janë të lidhura punët rreth krijimit të parave, grumbullimit të depozitave dhe kryerjes së qarkullimit të pagesave. Duke i përfshirë disa nga kriteret e lartëcekura, mund të themi se: banka është një institucion i posaçëm financiar i sistemit monetar kreditor që merret me marrjen dhe dhënien e kredisë në mënyrë profesionale, si dhe ndërmjetësimin në qarkullimin e pagesave të komitentëve. Sipas Dr. Felix Somary në veprën e tij “Bankpolitik”, thuhet se banka është një ent, puna kryesore e së cilës është marrja e kredive në formë të parave.⁸⁸ Somary i qaset funksionit bankës jo nga aspekti i dhënies së kredisë ose kryerjes së punëve të tjera bankare, por nga aspekti i ngarkimit me borxh (debitimit) të bankës. Ky definicion na bën të ditur se kuptimi i bankës nuk është vendimtar vetëm nga ana aktive, por nga ana pasive e bilancit për arsye se mjetet e bankës janë shumë të vogla në krahasim me mjetet që janë marrë hua. Për këtë arsye fuqia e bankës vlerësohet sipas sasisë së obligimeve të saj dhe besimit të cilin gëzon banka te deponuesit e saj.

2. Llojet e bankave dhe shërbimet e tyre

Ndërlikueshmëria, llojllojshmëria e aktiviteteve ekonomike dhe dinamika e tregut bashkëkohor të vendit dhe të jashtëm, detyruan bankën që

⁸⁸ Luboteni, Gazmend, “Menaxhmenti bankar”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.17

të jetë në trend me një gjendje të tillë dhe që afarizmin e saj ta harmonizojë me realizimin e rentabilitetit maksimal dhe të sigurisë së afarizmit të saj. Që të realizojë këtë, banka duhet të deponojë një kapital të caktuar, i cili do t'ia sigurojë kontinuitetin e afarizmit të veprimtarië saj. Dikur dominonin bankat e tipit universal, mirëpo me zhvillimin e forcave prodhuese bëhet specializimi gjithnjë e më i madh i bankave. Kriteri më i përhapur i klasifikimit të bankave është ai se si i siguron banka mjetet financiare.

Sipas këtij kriteri bankat ndahen në: Banka qendrore (emituese), banka komerciale (depozitare), afarsite, investive, të specializuara, universale, hipotekare, rregjionale, multinacionale, kursimore, etj.⁸⁹

- **Banka qendrore** – është banka e vetme e cila bën emitimin e parasë. Karakteristikë e bankave qendrore është se qëllimi i tyre nuk është fitimi, gjë që i bën të dallohen nga bankat tjera. Në të shumtën e rasteve bankat qendrore mbajnë emrin e shtetit të tyre, p.sh Banka qendrore e Kosovës (BQK), “Bank of England”, “Banque de France”, etj. Banka qendrore kryen këto punë me rëndësi: bën emisionin e parave, zbaton politikën montiare – kreditore e cila ka të bëjë me rregullimin e sasisë së parave në treg dhe stabilitetin monetar të vendit, kujdeset për likuiditetin ndërkombëtar, kryen punë në llogari të shtetit, etj. Një nga çështjet bazike të pozitës dhe të rolit të bankës Qendrore, është shkalla e pavarësisë së saj në raport me pushtetin ekzekutiv. Bashkëpunimi me bankat qendrore të vendeve të tjera jep rezultate efikase përmes së cilës mundësohet lehtësim dhe mbrojtje në nga spekulimet e ndryshme në tregun ndërkombëtar financiar.
- **Bankat komerciale** - janë bankat që bëjnë kreditimin afatshkurtër të prodhimit dhe të konsumit. Këto banka mjetet i formojnë nga depozitat e ekonomisë dhe kursimit të popullësisë. Në bazë të burimeve të mjeteve, japin kredi afatshkurtër për blerjen e mallërave dhe për këtë arsye quhen banka komerciale. Këto banka paraqesin bankat më të përhapura në botë dhe janë bazë e sistemit të ndërmjetësimit financiar. Karakteristikë e këtyre bankave është se kanë shumë komitentë dhe filiale të organizuara sipas principit territorial.
- **Bankat afariste** - paraqiten në vendet e zhvilluara duke disponuar kapitale të mëdha dhe zakonisht bëjnë kreditimin e ndërmarrjeve gjidante industriale. Banka të tilla janë: Bank of america, First National City Bank, etj.

⁸⁹ Luboteni, Gazmend, “ Bankat dhe afarizmi bankar ”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006, fq.12

- **Bankat investive** - janë organizata të specializuara bankare për kreditimin e investimeve, qka do të thotë se kreditimi i tyre është afatgjatë. Mjetet këto banka i sigurojnë duke dhënë fletëobligacione, afatizimin e depozitave investive, etj. Për shkak afatit të gjatë këto banka kërkojnë supergaranci për kthimin e mjeteve.
- **Bankat e specializuara ose të degëve** - janë bankat që themelohen për finncimin e degëve të ndryshme të ekonomisë (industrisë, bujqësisë, zejtarisë, tregtisë së jashtme, etj.)
- **Bankat universale** - janë banka të tipit të përzier të cilat merren me të gjitha punët bankare.
- **Bankat hipotekare** – janë organizata bankare për kreditim afatgjatë. Mjetet i sigurojnë duke bërë emisionin e plasmanin e aksioneve në treg duke rritur kështu kapitalin vetanak. Hipoteka është pengu i kredive të këtij lloji bankar.
- **Bankat rregjionale dhe bankat për zhvillim** – janë banka të cilat e ushtrojnë veprimtrinë e tyre në një territor të caktuar me qëllim të financimit të investimeve në ekonomi dhe infrastrukturë. Këto banka mund të punojnë në territorin e një vendi apo ta shtrijnë veprimtarinë në disa shtete. Banka të tilla janë: Banka Europiane Investive, Banka për Likuidimin e Llogarive në Bazel, etj.
- **Bankat komerciale** – janë bankat të cilat mobilizojnë mjetet e tyre me bashkimin e kapitaleve të bankave të njohura botërore. Këto banka lejojnë të gjitha llojet e kredisë, kryejnë punët me letra me vlerë, marrjen e depozitave, etj. Janë bankat më të përhapura dhe disponojnë mjete të shumëta financiare, gjë që ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi.
- **Kursimorja** – është formë e veçantë e organizatës bankare, që zhvillon kursimin dhe mbledh depozitat e kusimit të shtresave të gjerë të popullësisë, mban llogaritë rrjedhëse të qytetarëve dhe bën kreditimin e popullësisë. Paraqesin insitucionet më të vogla monetare, të cilat nëpër qytete e fshtatëra i pranojnë me kamatë kursimet e popullësisë dhe i lejojnë në formë të kredive konsumuese për popullësisë.

Në ditët e sotme bankat ofrojnë një numër të madh të shërbimeve, disa nga më të rëndësishmet janë: Dhënia e kredive të ndryshme, dhënia e këshillave financiare për biznese dhe individ, menaxhimi i parasë së gatshme, dhënia e pjimeve me qira, financimi i kompanive të reja, sigurimi dhe ruajtja e kursimeve dhe instrumenteve të ndryshme fiannciare, ofrimi i polisave të sigurimit të kredisë, ofrimi i planeve për pensionim, kryerja e shërbimeve të brokerëve, kryerja e shërbimeve lidhur me investimet dhe

=====

punët tregtare, ofrojnë informata mbi kontabilitet, investime, kredit kartela, llogari të ndryshme, e-banking, tregun, etj. Në përgjithësi del se bankat e sotme ofrojnë një spektër të gjerë të shërbimeve mirëpo edhe përkundër kësaj, lista e shërbimeve të cilat kryejnë bankat, vjen e zgjerohet vazhdimisht sepse qëllimi i vëtëm është krijimi i lehtësive sa më të mëdha për komitentët e vet.

3. Bankat në Kosovë dhe shërbimet e tyre

Sistemi bankar në Kosovë përbëhet nga banka e nivelit të parë e emëruar si Banka Qendrore e Kosovës dhe tetë banka komerciale.

- **Banka Qendore e Kosovës (BQK)** – është pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është subjekt juridik publik që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Është përgjegjës për licencimin e bankave dhe institucioneve tjera financiare.. Objektivat e BQK-së sipas ligjit në fuqi janë: Objektivi parësor i Bankës Qendrore është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave; Objektivi shtesë i Bankës Qendrore i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj, është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; Pa paragjykuar arritjen e këtyre objektiveve, Banka Qendrore mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë dhe vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.⁹⁰
- Një nga planet strategjike të BQK-së për bankat komerciale është zbatimi i standardeve Bazel II që kërkohet dhe për antarësim në BE, poashtu BQK ka për detyrë të mbikëqyrë sigurimin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë, zbatimin e skemës për sigurimin e depozitave, etj.⁹¹
- **Bankat komerciale në Kosovë** – përfshijnë pjesën më të madhe të aseteve nga të gjitha institucionet tjera financiare. Bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë: **“Procredit Bank (PCB)”**, **“Raiffeisen Bank Kosovo (RBK)”**, **“Nlb Prishtina Bank (NLB)”**, **“Banka Ekonomike e Kosovës (BEK)”**, **“Banka Private e Biznesit (BPB)”**, **“Turkish European Bank (TEB)”**,

⁹⁰ <http://www.bqk-kos.org/>

⁹¹ Pani strategjik 2010-2015, Banka Qendrore e Kosovës.

“Banka Kombëtare Tregtare (BKT)” dhe “Komericialna Banka ad Beograd” në Mitrovicë. Nga gjithsej këto tetë banka që operojnë në Kosovë, gjashtë janë me pronësi private dhe dy me pronësi shtetërore. Pjesëmarrja e bankave me kapital të huaj në gjithsej asetet e sektorit bankar është 91.6 përqind, ndërsa bankat me kapital vendor menaxhojnë 8.4 përqind të gjithsej aseteve. Kapitali i huaj në sektorin bankar në Kosovë kryesisht ka origjinën nga vendet e Bashkimit Evropian, siç janë Gjermania, Austria dhe Sllovenia, ndërsa me një shkallë më të vogël merr pjesë edhe kapitali nga Turqia, Shqipëria dhe Serbia. Rritja e konkurrencës në sektorin bankar u manifestua edhe me zgjerimin e vazhdueshëm të rrjetit të bankave komerciale. Zgjerimi i rrjetit deri në vitin 2010 kishte një ritëm më të ngadalshëm krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit të sektorit bankar si pasojë e krizës financiare globale.

Tabela 2. Rrjeti i sektorit bankar⁹²

	2007	2008	2009	2010
Numri i degëve dhe nëndegëve	219	231	267	292
Numri i të punësuarëve	2,329	2,701	3,430	3,664
Numri i ATMve	116	155	275	293
Numri i POSve	1,767	2,554	3,723	4,900
Numri i llogarive Ebanking	2,872	4,742	13,051	39,156

Numri i degëve dhe nëndegëve bankare në vitin 2010 arriti në 292 (nga 267 sa ishte në vitin 2009). Rritja e numrit të degëve është shoqëruar edhe me rritjen e numrit të të punësuarëve në sistemin bankar. Gjithsej numri i të punësuarëve në sistemin bankar është rritur nga 3,430 sa ishte në vitin 2009 në 3664 në vitin 2010, që paraqet një ngritje prej 6.8 përqind. Megjithatë, në fund të vitit 2010 vërehet një stagnim pothuajse i plotë për sa i përket rritjes së numrit të të punësuarëve. Nga tabela mund të shohim se bankat komerciale në Kosovë ofrojnë shërbime të llojeve të ndryshme. Kryesisht këto shërbime janë: hapja e llogarive rrjedhëse dhe kursimeve për të rritur dhe fëmijë, transferet kombëtare dhe ndërkombëtare, marrja e depozitave nga ana e bizneseve dhe individëve dhe afatizimi i tyre, ofrimi i linjave kreditore- mbitërheqjeve (overdrafte), ofrimi i kredit kartelave (psh.

⁹² Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK)

Starcard që ofrohet nga TEB banka), dhënia me lizing nga Raiffeisen banka, dhënia e kredive të ndryshme, e-banking, etj.

Debit kartelat që i ofrojnë bankat komerciale në Kosovë mund të jenë: Visa Classic, Visa Electron, Maestro, etj. Kurse kredit kartelat mund të jenë: Mastercard, Visa Credit card, etj. Përveq këtyre shërbimeve bankat komerciale në Kosovë ofrojnë edhe pagesa me kartelë përmes pikave terminale të shitjes (POS) dhe tërheqjes së mjeteve përmes bank automatëve (ATM).

Numri dhe shumat e kredive të lejuara dominojnë në pasqyrat e bankave komerciale kjo si pasojë e zhvillimit të dobët ekonomik. Sa i përket kushteve për dhënien e kredisë, janë shtrënguar në kohën e fundit për shkak të krizës financiare globale, gjë e cila nëse vazhdon mund t'i shkaktoj probleme të shumëta ekonomisë së vendit. Llojet e kredive që i japin bankat komerciale në Kosovë janë: Konsumuese për mallëra dhe shërbime, personale (*individuale*), studimore, hipotekare, biznese, auto kredi, për bujqësi, për renovim, për pushime, për blerje truallit, për ndërtim, etj. Kreditë të cilat peng e kanë hipotekën janë më afatgjatë. Duke u krahasuar me vendet në rajon normat e interesit të kredive konsiderohen mjaft të larta. Ato sillen rreth 7% - 24%. Kreditë me normë më të ulët të interesit marrin të punësuarit në institucione publike dhe që i marrin pagat përmes bankës kurse kredi me normë më të lartë të interesit marrin individët të cilët janë të punësuar në biznese private dhe që nuk e marrin pagën përmes bankës, kjo për arsye se egziston rreziku më i lartë të mos kthimit të kredisë tek këta individ. Lartësia e normës së kredive do të qëndrojë e njëjtë deri sa e kemi këtë lartësi të inflacionit dhe këtë zhvillim ekonomik. Me ndryshimin e këtyre dy fenomeneve do të ndryshojë edhe norma e interesit të kredive. Pra siç po e shohim se bankat komerciale në Kosovë ofrojnë shërbime të përafërta me bankat komerciale të vendeve tjera, kjo si pasojë e bashkëpunimit me filialet e tyre amë që gjenden në vendet e Eurozonës.

Përfundimi

Si rezultat i këtij punimi shkencor arrita në përfundim se bankat janë një ndër institucione kryesore financiare të një vendi. Ato ndihmojnë në zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet ekonomik. Llojllojshmëria e aktiviteteve ekonomike dhe dinamika e tregut bashkëkohor të vendit dhe të jashtëm ka bërë që të kemi lloje të shumëta të bankave. Me rritjen e konkurrencës, zhvillimin e teknologjisë dhe hapjen e firmave prodhuese kemi ekspansion të shërbimeve bankare. Këto lloje të shërbimeve bankare u ofrojnë lehtësira të shumëta klientëve të bankave.

Sipas treguesëve financiar sistemi bankar në Kosovë ka një qëndrueshmëri të lartë dhe përbëhet nga Banka Qendore e Kosovës dhe tetë banka komerciale. Mund të themi se llojet e shërbimeve të bankave komerciale në Kosovë janë të përafërta me llojet e shërbimeve të bankave të vendeve europiane. Kjo gjë ndikon pozitivisht dhe u lehtëson procedurat e bankave komerciale të Kosovës për integrim në BE. Ndër gjërat më shqetësuese për bankat në Kosovë vazhdon të mbetet norma e lartë e interesit të kredive, e cila po i dëmton bizneset dhe ekonominë në përgjithësi, mirëpo nga ana e bankave kjo gjë po arsyetohet për shkak të normës së lartë të inflacionit dhe zhvillimit të pa qëndrueshëm ekonomik. Besojmë se me përmirësimin e zhvillimit ekonomik do të eliminohet edhe ky fenomen dhe do të hapen dhe banka të llojeve tjera siç janë: bankat investive, hipotekare, etj.

Literatura

1. Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Afarizmi bankar dhe bankat”, Prishtinë, 2006.
2. Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Menaxhmenti bankar” Prishtinë, 2004.
3. Shelagh Heffernan “Modern banking”, London, 2006.
4. George Cooper “The origin of financial crises”, Great Britain, 2008.
5. Prof. Dr. Agim Paca “Bankat dhe sistemi bankar”, Prishtinë, 2005.
6. Xheladin Shatku “Paraja dhe aktiviteti ekonomik”, Shkup, 2004.
7. Raportet financiare periodike dhe vjetore , BQK, Prishtinë, 2009/2010.
8. Buletine dhe raporte statistikore, Bankave komerciale të vendit, 2009/2010.

Web:

www.bqk-ks.org
www.raiffeisen-kosovo.org
www.procreditbank-kos.com
www.bek-bank.com
www.bpbbank.com